

## KODI I ETIKËS

### I KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE



---

## PREAMBUL

Kodi i Etikës ka për qëllim t'u ofrojë organeve drejtuese, nënkomisionerit shtetëror të zgjedhjeve dhe administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, një set vlerash dhe parimesh mbi të cilat bazohet sjellja e tyre. Kodi trajton në mënyrë të përshtatshme përgjegjësitë në promovimin dhe mbrojtjen e vlerave etike në çdo aspekt të organizimit dhe aktiviteteve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kodi përfshin një qasje të përgjithshme ndaj sjelljes etike, një përshkrim të përgjithshëm të rregullave që duhen të ndiqen nga organet drejtuese, nënkomisioneri dhe administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kodi i Etikës është hartuar për të ndihmuar organet drejtuese, nënkomisionerin shtetëror të zgjedhjeve dhe administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë vendimet e duhura në rastet e dilemave etike me të cilat përballen gjatë ushtrimit të funksionit.

---

**KREU I**  
**QËLLIMI DHE PARIME TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Ky Kod ka për qëllim të garantojë etikë, sjellje të mirë e seriozitet në ushtrimin e detyrës publike për të rritur besueshmërinë e publikut ndaj zyrtarëve të përfshirë në proceset zgjedhore. Zyrtarët/punonjësit e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve të të gjitha kategorive dhe niveleve respektojnë parimet e rregullat e sjelljes dhe etikës.
2. Gjithashtu, ky Kod ka qëllim të angazhojë zyrtarët/punonjësit e KQZ-së:
  - a) t'u ofrojnë zgjedhësve shërbimin administrativ me cilësinë më të lartë, për t'u mundësuar atyre ushtrimin e të drejtës së votës pa pengesa në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
  - b) të edukojnë zgjedhësit dhe të nxisin pjesëmarrjen e tyre në procesin zgjedhor, nëpërmjet informimit të plotë, me fokus të veçantë grupet vulnerabël, pakicat kombëtare, personat me aftësi të kufizuara etj.

**Neni 2**  
**Fusha e veprimit**

1. Dispozitat e këtij Kodi janë të detyrueshme për Organet drejtuese të Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve, Nënkomisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe zyrtarët/punonjësit e Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve pavarësisht nga funksioni i tyre ose niveli hierarkik, që bën pjesë në kategoritë e mëposhtme:
  - a) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,
  - b) Komisioni Rregulator,
  - c) Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,
  - ç) Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,
  - d) Nëpunësit civilë të Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve dhe ata të punësuar me kohëzgjatje të pacaktuar sipas Kodit të Punës,
  - dh) Punonjësit e punësuar në kabinetin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,
  - e) Punonjësit e punësuar me kohëzgjatje të caktuar gjatë periudhave zgjedhore,
  - ë) Administrata zgjedhore e niveleve të tjera në periudhë zgjedhore,
  - f) Praktikantët që ushtrojnë praktikën pranë Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve.
2. Dispozitat e këtij Kodi vendosin standardin minimal të zbatueshëm të rregullave të etikës që duhet të zbatohen nga kategoritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

**Neni 3**

## Parime të përgjithshme

1. **Parimi i ligjshmërisë.** Zyrtari i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve duhet të zbatojë Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe legjislativin që rregullon marrëdhëniet në administratën publike, në përputhje me funksionet që dhe ushtron detyrat që kryen.
  - a) Duhet të sigurojë, brenda kuadrit ligjor, që aktet nënligjore dhe zbatimi i tyre në lidhje me zgjedhjet të zbatohet plotësisht në mënyrë të ndershme, të quartë, të paanshme dhe të barabartë për të rritur besimin e publikut dhe subjekteve në proceset zgjedhore
  - b) Të sigurohet që në përputhje me kuadrin ligjor, çdo kandidat, subjekt apo parti politike, zgjedhës apo pjesmarrës tjetër në procesin zgjedhor të trajtohet në mënyrë të ndershme, të barabartë duke marrë në konsideratë të gjitha rrëthanat.
  - c) Të sigurojë që nëpërmjet zbatimit korrekt të ligjit të krijojë besueshmërinë e të gjithë pjesmarrësve në proceset zgjedhore, referendare.
2. **Objektiviteti.** Zyrtari i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes të detyrave, duhet të marrë në konsideratë faktorët përkatës dhe t'i japë secilit prej tyre peshën e duhur në qëndrimin përfundimtar, duke përashtuar çdo element që nuk i përgjigjet procesit konkret të punës.
3. **Paanshmëria, ndershshmëria dhe pavarësia.** Zyrtari i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes të detyrave duhet të jetë i paanshëm, i drejtë, i arsyeshëm dhe i pavarur. Ai duhet të shmangë çdo veprim, mosveprim arbitrar apo çdo trajtim preferencial, si dhe të jetë i pandikuar nga çdo interes tjetër, personal, politik, familjar dhe shoqëror.
4. **Përgjegjshmëria.** Zyrtari i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve duhet t'u shërbejë interesave dhe nevojave të ligjshme të Komisionit Qendorr Zgjedhjeve dhe qytetarëve, në kohën e duhur, me kujdes, respekt dhe përgjegjësi.
5. **Parimi i mosdiskriminimit.** Zyrtari i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes të detyrave, me veprimet ose mosveprimet e tij, nuk duhet të favorizojë apo të diskriminojë një subjekt të caktuar për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjes politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzanisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për ndonjë shkak tjetër të ngjashëm.
6. **Transparenca.** Komisioni Qendorr i Zgjedhjeve dhe çdo zyrtar i tij gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes të detyrave, respekton parimin e transparencës dhe informimit të

publikut në përputhje më Kushtetutën, Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe ligjin nr. 114/2019 “Për të drejtën e informimit”.

7. **Konfidencialiteti.** Zyrtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjatë ushtrimit të funksionit dhe kryerjes të detyrave ruan konfidencialitetin e informacionit publik që harton dhe disponon në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënavë personale”, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe çdo akt tjeter ligor që mbron dhe klasifikon informacionin.
8. **Konflikti i interesit.** Zyrtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të parandalojë, si dhe të marrë të gjitha masat për ndërprerjen e gjendjes së konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave të tij privatë.

## KREU II

### **RREGULLAT E ETIKËS PËR ORGANET DREJTUESE DHE NËNKOMISIONERIN SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

#### Neni 4

##### **Kryerja e detyrave me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve të tjera drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të marrin pjesë në shqyrtimin dhe vendimmarrjen për një çështje, nëse ka interes personal ndaj saj.
2. Në respektim të parimit të kryerjes së detyrave me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, duke pasur parasysh vetëm interesin publik dhe me qëllim që sjellja e tij t'i shërbejë ruajtjes dhe rritjes së besimit të publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve kanë detyrimin të ndjekin dhe zbatojnë këto rregulla:
  - a) Në çdo rast, vepron me integritet të lartë moral dhe profesional, gjatë ushtrimit të funksionit,
  - b) Sjellja personale duhet të jetë e tillë që të reflektojë ndershmëri, të promovojë vlerat e parimet më të larta etiko-morale dhe të inkurajojë zyrtarët/punonjësit e tjerë të KQZ-së të veprojnë në përputhje me këto vlera,
  - c) Gjatë ushtrimit të detyrës, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarë i organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:
    - i. ndjek e zbaton parimin e deburokratizimit dhe të eficiencës, duke siguruar që çdo procedurë të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, brenda afateve ligjore.
    - ii. garanton interesin publik e institucional.
    - iii. kryen të gjitha detyrat i pandikuar politikisht duke ruajtur neutralitetin dhe pa cënuar besueshmërinë e institucionit.

## Neni 5

### **Shfaqja e mendimit, konfidencialiteti dhe solidarisisë**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe secili prej anëtarëve të organeve drejtuese të Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve ka të drejtë të shprehë lirisht mendimin dhe pikëpamjet e veta dhe të ushtrojë pa pengesa të drejtën e votës për vendimmarjet, objekt shqyrtimi.
2. Pas marrjes së vendimit, anëtarët e organeve drejtuese të Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve duhet të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve, mendimeve, informacioneve dhe vlerësimeve të debateve, të shprehura jashtë mbledhjeve/seancave publike.

## KREU III

### **RREGULLAT E ETIKËS PËR ZYRTARËT/PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

## Neni 6

### **Kryerja e detyrate me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet**

1. Në respektim të parimit të kryerjes së detyrate me ndershmëri, paanshmëri, efikasitet, duke pasur parasysh vetëm interesin publik dhe me qëllim që sjellja e tij t'i shërbejë ruajtjes dhe rritjes së besimit të publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik, zyrtari/punonjësi i Komisionit Qendorr të Zgjedhjeve (KQZ-së) ka detyrimin të ndjekë dhe zbatojë këto rregulla:
  - a) Në çdo rast, zyrtari/punonjësi i KQZ-së vepron me integritet të lartë moral dhe profesional, në funksion të kryerjes së veprimtarisë administrative;
  - b) Sjellja personale e zyrtarit/punonjësit i KQZ-së duhet të jetë e tillë që të reflektojë ndershmëri, të promovojë vlerat e parimet më të larta etiko-morale dhe të inkurajojë zyrtarët/punonjësit e tjera të veprojnë në përputhje me këto vlera;
  - c) Zyrtari/punonjësi i KQZ-së duhet të jetë i paanshëm, i besueshëm, transparent, efektiv, duke realizuar me disiplinë dhe në kohë detyrat funksionale, në respektim të interesit publik;
  - ç) Zyrtari/punonjësi i KQZ-së përdor në mënyrë efektive kohën e punës për realizimin me përgjegjësi dhe korrektësi të detyrate funksionale, duke kontribuuar në rritjen e performancës së administratës;
  - d) Gjatë ushtrimit të detyrës, zyrtari i KQZ-së:
    - i. ndjek e zbaton parimin e deburokratizimit dhe të eficiencës, duke siguruar që procedura administrative të zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, brenda afateve

- ligjore dhe me sa më pak kosto, bazuar në standardet më të larta të saktësisë së informacionit.
- ii. jep mendime e opinione objektive, bazuar në dijeninë dhe në përvojën profesionale, duke garantuar paprekshmérinë e interesit publik e institucional, mbi atë personal.
  - iii. kryen të gjitha detyrat e tyre në mënyrë politikisht neutrale për të shmangur perceptimet se angazhimi i tyre është i njëanshëm, i ndikuar politikisht dhe që cënon besueshmérinë e institucionit.
2. Në ushtrimin e detyrës, zyrtarët e administratës zgjedhore të niveleve të tjera, edhe pse propozohen nga partitë politike, duhet të udhëhiqen nga interesi publik dhe të trajtojnë në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe të pandikuar politikisht, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupei interesit. Ata nuk duhet të shfaqin simbole apo shenja dalluese partiake. Zyrtari i administratës zgjedhore të niveleve të tjera duhet të shmangë, refuzojë influencime të papërshtatshme dhe të deklarojë rrethanat që e çojnë atë në kushtet e konfliktit të interesave.
- Neni 7**  
**Paraqitura e punës, mirësjellje dhe respekti**
1. Paraqitura e zyrtarit/punonjësit në punë duhet të jetë e përshtatshme dhe e tillë që të shprehë:
    - a) Vëmendje në mënyrën e komunikimit dhe të qëndrimit në ambientet e KQZ.
    - b) Kujdesin dhe seriozitetin e vazhdueshëm për pamjen e jashtme;
    - c) Plotësimin e kërkesave të domosdoshme të veshjes zyrtare në mjediset e KQZ.
  2. Zyrtarët/punonjësit e KQZ-së duhet t'i trajtojnë kolegët e tyre, eprorët apo vartësit, me mirësjellje dhe respekt, duke përashtuar nga fjalori fjalë apo shprehje të papërshtatshme të cilat thyejnë besimin e zyrtarit/punonjësit të vetja dhe puna. Sjellja e zyrtarëve/punonjësve të KQZ-së nuk mund të tregojë tendencia të ngacmimive fizike apo me fjalë.
  3. Do të konsiderohen si ngacmimë dhe do të trajtohen si të tillë, të gjitha ato fjalë apo sjellje që ndërhyjnë në mënyrë të paarsyeshme në punën e gjithkujt apo që krijojnë një mjedis pune frikësues (kërcënues), armiqësor dhe fyes.
  4. KQZ-ja do të jetë, gjithashtu e vëmendshme lidhur me sjelljet e pahijshme, të shprehura publikisht, verbalisht apo nëpërmjet llogarive personale në rrjetet sociale.

**Neni 8**  
**Zgjidhja e problemeve dhe e konflikteve personale**

1. Zyrtarë e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues kanë përgjegjësinë të jenë të disponueshëm për anëtarët e stafit, të cilët duan të ngrenë shqetësimë apo të diskutojnë çështje në konfidencë (vetëm për vetëm) dhe t'i trajtojnë me ndjeshmëri, paanshmëri, objektivitet dhe pa diskriminim situata të tillë.

2. Zyrtarë e nivelit të lartë dhe të mesëm drejtues duhet të krijojnë një atmosferë, ku anëtarët e stafit të tyre të ndjehen të lirë të përdorin (pa patur frikë për ndëshkime), rrugët institucionale ekzistuese për zgjidhjen e problemeve apo të konflikteve të çdo lloji, si edhe të shprehin shqetësimë lidhur me situatat problematike apo konfliktuale ku ndodhen ose ku mund të ndodhen, jo vetëm lidhur me marrëdhëniet e tyre brenda KQZ-së.
3. Në çdo rast dhe për çdo problem të tillë punonjësit e KQZ-së kanë të drejtë të adresojnë kërkesën e tyre për takim me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, me synim trajtimin e situatave, sjelljeve, dilemave, shqetësimëve apo problemeve etike. Komisioneri realizon brenda një kohe të përshtatshme çdo takim të tillë.

### **Neni 9** **Përdorimi i kohës së punës**

Zyrtarët/punonjësit e KQZ-së duhet të përdorin në mënyrë efektive kohën e punës. Koha e punës nuk duhet përdorur për asnje qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar në përputhje me ligjet dhe me rregullat në fuqi. Në funksion të përdorimit sa më efikas të burimeve në dispozicion, punonjësit e KQZ-së duhet t'i kushtojnë kohën e punës vetëm veprimtarive dhe aktiviteteve zyrtare.

### **Neni 10** **Përdorimi i pronave, i pajisjeve dhe i burimeve të KQZ-së**

Zyrtarët/punonjësit e KQZ-së duhet të menaxhojnë me kujdes pronën publike (asetet në pronësi/administrim) të KQZ-së, si dhe dokumentacionin zyrtar. Nuk lejohet që, drejtpërsëdrejti ose jo, zyrtarët/punonjësit e KQZ-së të përdorin apo të lejojnë që prona të përdoret për qëllime të tjera, përveçse për realizimin e detyrave.

### **Neni 11** **Qasja në informacion dhe konfidencialiteti**

1. Zyrtari i KQZ-së promovon transparencën dhe qasjen në informacionin e prodhuar dhe administruar nga institucioni në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.
2. Zyrtari i KQZ-së mund të publikojë ose të vendosë në dispozicion të publikut vetëm informacionin i cili vlerësohet si informacion publik në kuptim të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, pasi ka marrë miratimin e eprorit në përputhje me rregulloren e institucionit.
3. Nëpunësi nuk duhet të përdorë, keqpërdorë apo shpërndajë informacionin e marrë në punë përtej qëllimit për të cilin synohet informacioni.
4. KQZ respekton konfidencialitetin e stafit. Informacionet konfidenciale (përfshirë dosjet

personale, shënimet mjekësore, informacione lidhur me hetime të ndryshme), nuk do të lejohet që të keqpërdoren, nuk do të zbulohen dhe do të lejohet që të njihen me to vetëm personat e autorizuar.

5. **Zyrtarët e KQZ-së duhet:**

- a) të arsyetojnë vendimmarjet në të cilat angazhohen
- b) të bëjnë të disponueshëm çdo lloj informacioni mbi të cilën është bazuar vendimmarja
- c) të garantojnë aksesin efektiv dhe të arsyeshëm në dokumente dhe informacion, brenda kuadrit ligjor, në mënyrë që çdo zgjedhës, kandidat, subjekt dhe shoqëria civile të ushtrojnë të drejtat e tyre.
- c) t'u japid sqarime kërkesave të arsyeshme për vendimmarjet e tyre, pjesë e procesit zgjedhor.
- d) të konsultohen me pjesmarrësit në procesin zgjedhor dhe grupet e interesit për çdo vendimmarje që lidhet me procesin zgjedhor.
- dh) të japid informacion të saktë e në mënyrë të barabartë për palët në proces.
- e) të sigurohen që i gjithë informacioni i hartuar, përdorur apo publikuar të bazohet mbi fakte.

**Neni 12**  
**Konflikti i interesave**

- 1. Gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të tij zyrtari i KQZ-së duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik, të parandalojë, të shmangë dhe të ofrojë zgjidhje për situatat e konfliktit të interesave.
- 2. Zyrtari duhet të evitojë çdo situatë që përbën shkak për lindjen e një konflikti interesit si dhe nuk duhet të krijojë përfitime të mundshme për veten e tij/saj, familjarët dhe të afërmët gjatë ushtrimit të detyrës publike.
- 3. Kur zyrtari, gjatë ushtrimit të detyrës publike, ka dijeni se ekziston një situatë konflikti interesit, ai duhet:
  - a) të verifikojë nëse ka një konflikt në dukje apo të mundshëm interesash;
  - b) të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë;
  - c) të vëré në dijeni menjëherë, me nismën e tij, eprorin direkt dhe njësinë e Burimeve Njerëzore, për situatën e konfliktit të interesave.
- 4. Kur kërkohet nga struktura përgjegjëse, zyrtari duhet të japë të gjitha informacionet e nevojshme për vlerësimin e konfliktit të mundshëm të interesave.
- 5. Deklarata mbi konfliktin e interesit konsiderohet konfidenciale, përvèç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj.

**Neni 13**  
**Veprimtaritë e jashtme**

1. Veprimtaritë e jashtme të zyrtarëve të KQZ-së janë të lejueshme vetëm kur nuk bëhen pengesë për përbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive zyrtare.
2. Zyrtari i KQZ-së nuk mund të angazhohet në një veprimitari të jashtme, nëse:
  - a) ajo krijon ose duket sikur krijon një konflikt interesash me pozicionin e tij zyrtar;
  - b) angazhimi mendor e fizik i nëpunësit në këtë veprimitari ndikon në kryerjen normale të detyrave të tij zyrtare, pengon ose e bën të vështirë kryerjen e tyre;
  - c) veprimitaria që kryen cënon figurën e tij ose të KQZ-së
  - c) veprimitaria që kryen është vazhdim i detyrave të tij zyrtare dhe zyrtari duhet të përdorë të dhënat që ka nga pozicioni i tij;
  - d) qëllimi i veprimtarisë bie në kundërshtim me qëllimin dhe objektivat e pozicionit zyrtar të punës;
  - dh) është një veprimitari që kryhet me kohë të plotë.
3. Nuk konsiderohet si veprimitari e jashtme e palejueshme, veprimitaria në kuadër të shoqatave kulturore, shoqërore apo sportive, pjesëmarrja në organet drejtuese të këtyre shoqatave, me përjashtim të rasteve kur kjo ndalohet shprehimisht nga ligji dhe/ose kur ajo pengon kryerjen normale të detyrës zyrtare.
4. Në rastet kur Zyrtari i KQZ-së, me miratimin e titullarit/eprorit, kryen veprimitari mësimdhënieje apo trajnuese gjatë orarit zyrtar, ai është i detyruar të kompensojë orët e punës brenda javës, pas orarit zyrtar të punës.

## **Neni 14**

### **Dhuratat dhe favoret**

1. Zyrtari/punonjësi i KQZ-së nuk duhet të kërkojë apo të pranojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, për veten, familjen, të afërm, personat fizikë apo juridikë me të cilët ka marrëdhënie:
  - a) dhurata, favore, pritje apo çdo përfitim tjetër, si dhe premtimë për to, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, me efekt përfitimi të çfarëdoshëm për dhuruesin ose persona të tretë, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanshmërinë e kryerjes së detyrës, që janë ose duket sikur janë shpërbirim për mënyrën e kryerjes së detyrës;
  - b) ftesa për pritje të ndryshme, premtimë, ofrime falas apo ulje të çmimeve për kryerjen e shërbimeve, të argëtimeve, pushimeve, transporteve, udhëtimeve;
  - c) përfitime të bursave të studimit dhe/ose të sigurimeve.
2. Zyrtari/punonjësi i KQZ-së nuk duhet të kërkojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të japë dhurata ose të ndërmjetësojë për të dhënë dhurata për një nëpunës të një niveli më të lartë apo të afërm të tij dhe as të kërkojë ose të pranojë dhurata nga nëpunës i një niveli më të ulët ose të afërm të tij, për shkak të cilësive dhe raporteve zyrtare.

3. Rregullat e përcaktuara në pikën 1 të këtij nenit, nuk zbatohen në rastin e ftesave të zakonshme apo kur janë të ftuar nëpunës ose kolegë të tjerë, të mikpritjes tradicionale, dhuratave me vlerë simbolike apo tradicionale dhe të mirësjelljes, brenda kufijve normalë të traditës, zakoneve, lidhjes farefisnore dhe praktikës së përditshme, të cilat nuk krijojnë dyshime për paanësinë e nëpunësit.
4. Zyrtari/punonjësi i KQZ-së mund të pranojë dhurata nga qeveritë e huaja apo organizatat ndërkombe, brenda kufijve normalë të shprehjes së mikpritjes dhe trajtimit që buron prej saj, kortezi së apo protokollit, nëse nuk tejkalojen kufijtë e traditës e të zakoneve të vendit ku jepen, nuk vënë në dyshim objektivitetin, ndershmërinë dhe paanshmërinë e nëpunësit e nëse nuk kompromentojnë imazhin dhe integritetin e institucionit.
5. Në asnjë rast, zyrtari/punonjësi i KQZ-së nuk duhet të pranojë dhurata në vlerë monetare.
6. Janë të ndaluara të gjitha dhuratat që çojnë në konflikt interesit sipas legjislativit të këtë fushë, pavarësisht vlerës së tyre.

**Neni 15**  
**Detyrimet e zyrtarit pas periudhës së punësimit**

1. Zyrtarët e KQZ-së, pas largimit nga detyra nuk duhet ta përdorin informacionin konfidencial, të marrë gjate kryerjes se detyrës, për interes personal.
2. Për një periudhë kohe 2-vjeçare, pas largimit nga detyra, ish-zyrtari nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me KQZ-në, për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi te saj.

**KREU IV**  
**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**Neni 16**  
**Zbatimi i Kodit**

1. Njësia përgjegjëse për burimet njerëzore është e detyruar t'i bëjë të ditur zyrtarit/punonjësit në çastin e punësimit të tij detyrimet që rrjedhin nga ky Kod.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarët e organeve drejtuese të KQZ-së, Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, si dhe zyrtarët/punonjësit e KQZ-së, janë të detyruar të zbatojnë parashikimet e këtij Kodi.